



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA MIRËQËNIES
SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËTËROR
DREJTORIA E KONTROLLIT TË NE DHE PAGESËS SË PAK

Nr.129/4 Prot.

Tiranë, më 01.03.2016

Lënda: Njoftim mbi raportin e kontrollit

Drejtuar: **Z. Roland XHELILAJ**
Prefekt i Qarkut Durrës

Z. Vangjush DAKO
Kryetar i Bashkisë Durrës

Z. Albert DONKSHI
Administrator i Njesisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës

Z. Dorian HATIBI
Drejtor i Drejtorisë Rajonale Durrës

Mbështetur në programin e kontrollit Nr.129 Prot, datë 18.01.2016, mbi zbatimin e legjislacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, përfitimin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar dhe përfitimin e pagesës së personave me statusin e invalidit të punës, specialistët e Shërbimit Social Shtetëror realizuan kontrollin në Njesisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës.

Njësia Administrative Sukth ka një popullsi prej 27.900 banorësh dhe 6.750 familje. Në janar 2015 njësia administrative trajtonte me ndihmë ekonomike 66 familje me një fond 341.880 lekë, ndërsa në dhjetor 2015 trajton me ndihmë ekonomike 50 familje me një fond 261.780 lekë. *Pra kjo njësi administrative ka ulje të numrit të përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike me 16 familje.*

Në zbatim të ligjit nr 9355, dt.10.03.2005 “Për Ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, akteve ligjore e nënligjore për përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike, të ndryshuar me ligjin nr 10399, dt. 17.03.2011 dhe VKM nr.787 datë 14.12.2005, ndryshuar me VKM nr.96 dt.07.02.2012, Njësia Administrative Sukth u kontrollua për zbatimin e legjislacionit.

Nga kontrolli rezultoi

I- Kontrolli mbi zbatimin e detyrave të lëna.

Kontrolli i fundit është bërë nga Drejtoria Rajonale Durrës në bazë të programit të kontrollit nr. 181/1 prot. dt.10.02.2015 dhe janë lënë 2 detyra.

Nga kontrolli mbi realizimin e detyrave të lëna rezultoi se detyrat ishin realizuar.

II- Ndihma Ekonomike

1. Rregjistri Kombëtar elektronik me të dhënat e aplikuesve për Ndhimën Ekonomike është i plotësuar sipas dokumentacionit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

2. Administratori shoqëror ka në dosje të veçantë Projekt-Vendimet, Vendimet dhe Borderotë, si dhe bashkëngjitur janë edhe listat e përfituesve të ndihmës ekonomike deri në korrik 2015.

3. Për periudhën gusht-dhjetor 2015 vendimet ndodhen në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Bashkia Durrës.

4. Sipas pikës 21 të Udhëzimit nr. 9, datë 23/06/2014 mbi zbatimin e VKM 904, datë 12.12.2012, vendimi për propozim gjeneruar nga Këshilli i Bashkisë Sukth, **nuk është shoqëruar me relacionin përkatës** për kryefamiljarët në nevojë, të cilët janë vlerësuar nga ana e tyre si familje të varfra.

5. Gjatë kontrollit mbi zbatimin e saktësisë së plotësimit të pagesave në P/vendim-Vendim, Vendim - Bordero, Bordero – Thesar rezultoi se ka përputhje të shumave të P/Vendimit, Vendimit, Borederosë dhe Thesarit.

6. Në bazë të Udhëzimit nr.9, datë 23.06.2014, mbi zbatimin e VKM 904, datë 12.12.2012, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot”, pika 27, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror i paraqet Kryetarit të Bashkisë vendimin final, për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike.

7. Administratori shoqërorë i njësisë administrative në bazë të këtij udhëzimi *nuk ka afishuar çdo muaj listat me emrat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit.*

8. Administratori shoqërorë i njësisë administrative shoqëror nuk kishte intervistuar dhe verifikuar situatën social – ekonomike të familjeve përfituese 2 herë në vit por vetëm një herë brenda vitit 2015.

9. Nga verifikimi në familje i kryer nga grupi i kontrollit u vu re që kishte përputhshmëri me të dhënat e deklaruara nga administratori në sistem për familjet e mëposhtme:

Sh.K (familje me 5 anëtarë)

L.Z (familje me 6 anëtarë)

E.B (familje me 6 anëtarë)

F.C (familje me 2 anëtarë)

U bë verifikimi social-ekonomik i familjes **Q.D** që nuk është përfituese e ndihmës ekonomike, duke u bazuar në ankesën e qytetares. Nga verifikimi rezultoi se familja është në gjendje të vështirë social-ekonomike.

Nga verifikimi në familjen **M.P** u vu re që kushtet në banesë janë shumë të mira.

Në dosjen e përfitueses kishte mbaruar afati i vërtetimit që bashkëshorti i saj ishte në arrest shtëpie.

III- Aftësia e Kufizuar

- 1. Janë hapur dosjet personale** për cdo përfitues (të paaftë dhe kujdestar) me numër rendor.
- 2. Dosjet e PAK për rikomisionim** dërgohen me proces-verbal pranë mjekut të Drejtorisë Rajonale Durrës siç përcaktohet në pikën 24 të VKM Nr.618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”.
- 3. Dosja e legjislacionit** ishte e plotësuar me udhëzimet dhe ligjet e fundit.
- 4. Regjistri i PAK** është hapur për vitin 2015.
- 5. Evidencat statistikore** për personat me aftësi të kufizuar sipas tabelave (1-6 , 1-7 , 1-8 , 1-9) nuk janë plotësuar në mënyrë korrekte sipas udhëzimit nr.10 datë 03/07/2014.
- 6. Zbatohet Sqaruesja e Drejtorit të Përgjithshëm** të SH.S.SH datë 10.05.2013 .
- 7. Zbatohet Urdhëri Nr.1261**.Prot, datë 12.06.2014 i Drejtorit të Përgjithshëm të SH.S.SH, “ Mbi procedurat e dhënies së librezës për statusin e verbërisë, të para dhe tetraplegjisë dhe të jetimit.”
- 8. Zbatohet Urdhëri Nr.1716**. Prot, datë 06.08.2014 i Drejtorit të Përgjithshëm të SH.S.SH, “ Mbi rikomisionimin e personave që kanë përfituar statusin e të verbërit me vendim të K.M.C.A.P deri ne vitin 2001.”
- 9. Nuk zbatohet Vendimi nr. 328** datë 12.03.2009 , Për disa shtesa në Vendimin nr.618 datë 07.09.2006 , “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar.
- 10. Të plotësohen** me librezat e para-tetraplegjikut dosja e Sh.S dhe dosja e A.B pasi i kanë mbaruar afati i librezës

Detyrat e lëna:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen lihen këto detyra:

- 1. Të plotësohen dosjet e përfituesve të ndihmës ekonomike** me kopje të vërtetimit të K.M.C.A.P - it për familjet që kanë persona me aftësi të kufizuar, në bazë të VKM 904 datë 12.12.2012, pika 3, gërma ë.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratori shoqëror

2. Të zbatohet pika 21 e Udhëzimit nr. 9, datë 23/06/2014 mbi zbatimin e VKM 904, datë 12.12.2012, ku vendimi për propozim gjeneruar nga Këshilli i Bashkisë, të shoqërohet me relacionin përkatës për kryefamiljarët në nevojë, të cilët janë vlerësuar nga ana e tyre si familje të varfra.

Afati : Vazhdimisht
Personi përgjegjës: Këshilli i Bashkisë

3. Të konsultohet çdo muaj në sistem raporti i deklarimeve 3 mujore, të gjenerohen dhe të plotësohen dosjet me deklaratat 3 mujore të familjeve përfituese.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratori shoqëror

4. Të bëhet verifikimi i gjendjes social- ekonomike për familjet që nuk ishin kryer, në bazë të VKM Nr.904, datë 12.12.2012 dhe në bazë të Udhëzimit nr.9, datë 23.06.2014 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot” pika 32,33.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratorët shoqërorë

5. Të afishohen çdo muaj listat me emrat e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit, në bazë të Udhëzimit nr.9, datë 23.06.2014, mbi zbatimin e VKM 904, datë 12.12.2012, “Për përcaktimin e kriteve të procedurave dhe të dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot”, pika 27.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratori shoqëror

6. Të korrigjohen aplikimet që janë bërë gabime në lidhje me pyetjen “A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar ose pension invaliditeti” për B.S dhe Y.Ç.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratori shoqëror

7. Të plotësohet dosja e M.P me vërtetimin që bashkëshorti i saj ishte në arrest shtëpie.

Afati : Brenda muajit shkurt
Personi përgjegjës: Administratori shoqëror

8. Të plotësohen evidencat statistikore për personat me aftësi të kufizuar sipas tabelave (1-6 , 1-7 , 1-8 , 1-9) në mënyrë korrekte sipas udhëzimit nr.10 datë 03/07/2014.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratorët shoqëror

9. Të zbatohet Vendimi nr. 328 datë 12.03.2009 , Për disa shtesa në Vendimin nr.618 datë 07.09.2006 , “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar.

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratorët shoqëror

10. Të plotësohen me librezat e para-tetraplegjikut dosja e Sh.S dhe dosja e A.B pasi i kanë mbaruar afati i librezës .

Afati : Menjëherë
Personi përgjegjës: Administratorët shoqëror

Etleva Bisha

DREJTOR I PËRGJITHSHËM